



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS:
Metodologji e kërkimit shkencor në kontekst didaktik

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II , Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master–

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Realizimi i këtij moduli plotëson një nevojë profesionale dhe shoqërore në fushën e edukimit dhe formimit të mësuesve kërkues. Kjo lëndë pretendon të japë një panoramë të përgjithshme dhe praktike të punës kërkimore shkencore duke u marrë me tema të veçanta në fushën e didaktikës së gjuhës frënge dhe që bazohen në punën në grup të studentëve.

Orët e para mësimore do të kushtohen zbulimit të fushës së kërkimit shkencor, koncepteve dhe principeve të tij teorikë dhe metodologjikë. Leksionet dhe seminarët në vijim do të synojnë përfitim dhe thellimin nga studenti të mjeteve kërkimore të domosdoshme për mbledhjen e të dhënave, analizën dhe interpretimin e materialeve. Orët e tjera mësimore do të kushtohen prezantimit dhe analizës së disa rasteve studimore duke ftuar studentët të aplikojnë metodologjitë e kërkimit të përfituara gjatë mësimi.

Njohuritë: Formimi i një përvojë të punës kërkimore në mjedisin studentor në fushën e mësimdhënies.

- Inkurajimi i studentëve në ndërmarrjen e iniciativave për punë të pavarur kërkimore shkencore në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Edukimi i studentëve me respektimin e parimeve bazë të punës kërkimore.
- Aftësimi i studentëve në hartimin e projekteve kërkimore si edhe me përpunimin e metodologjive të realizimit të eksperimentimit shkencor në terren në kontekstin shkollor.

Aftësitë dhe kompetencat

- Ky modul ka për objektiv të pajisë studentët me parimet themelore të kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies;
- Të njohë studentët me metodologjinë e kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies;
- Të aftësojë studentët me parimet e mbledhjes, përpunimit, analizës dhe interpretimit të të dhënave;
- Të aftësohen studentët në përcaktimin e problematikave kërkimore si edhe në hartimin e projekteve kërkimore me tematika të ndryshme që preokupojnë aktualisht fushën e didaktikës.
- Të aftësohen dhe inkurajohen studentët në procesin e eksperimentimit të një projekti kërkimor individual apo kolektiv.
- Të aftësohen për të përzgjedhur dhe referuar bibliografi shkencore të mirëfilltë